

MIGRANTËT DHE AZIL KËRKUESIT



Mitrovicë
2022

Ky publikim është përgatitur me mbështetjen e mirë të Bashkimit Evropian në kuadër të projektit rajonal “Siguria për qeniet njerëzore dhe kufijtë – Luftimi i kontrabandës së migrantëve në Ballkanin Perëndimor”. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe Këshillit Ballkanik për Refugjatët dhe Migracionin (BRMC).

HYRJE

Raporti në vijim është një përmbledhje e studimit hulumtues që synon vlerësimin, profilizimin dhe raportimin e gjendjes së individëve apo grupeve të emigrantëve me origjinë kryesisht nga Lindja e Mesme dhe Afrika e Veriut, që lëvizin nëpër territorin e Kosovës dhe rajonin e saj verior të Mitrovicës në rrugën e tyre drejt Bashkimit Evropian. Raporti, gjithashtu mbulon çështjet me të cilat përballen emigrantët gjatë qëndrimit të tyre në Kosovë, praktikën e menaxhimit institucional, rolet dhe përgjegjësitë e autoriteteve lokale, agjencive për zbatimin e ligjit dhe organizatave joqeveritare.

Bashkimi Evropian gjatë dekadës së fundit është duke përballur me krizën e emigrantëve, mirëpo ngjarja më e rëndë ndodhi në vitin 2015 kur një fluks i papritur i më shumë se një milion njerëzve nga globi jugor lëvizën lirshëm nëpër një numër kufijsh duke hyrë në Bashkimi Evropian. Fillimisht, kjo ngjarje u konsiderua si një shqetësim i vogël; megjithatë, papritur e zhvendosi vëmendjen e vendeve të BE-së nga natyra e saj humanitare në shqetësime serioze të sigurisë dhe të gjitha çështjeve themelore në lidhje me të.

Rreth 700.000 individë nga rajonet e Lindjes së Mesme dhe Afrikës Veriore përdorën të ashtuquajturën rrugën ballkanike për në Evropën qendrore. Zgjidhja e kësaj krize u arrit përfundimisht në mars të vitit 2016 me një marrëveshje në mes të Turqisë dhe BE-së, ku Turqia u pajtua të ndalonte fluksin e emigrantëve që nuk kishin nevojë për mbrojtje ndërkombëtare. Që nga atëherë, situata, nga pikëpamja e migrimit, në Ballkanin Perëndimor ka mbetur relativisht e qetë me flukse të reduktuara të migrimit dhe me disa korridore ende ekzistuese, pavarësisht gjendjeve kufizuese të lëvizjes.

Pjesa kryesore dhe fokusi i këtij studimit hulumtues kanë qenë rinisja dhe rishfaqja e migrimit të individëve ose grupeve në periudhën 2020/2021, që kalon nëpër Kosovë dhe rajonin e saj verior të Mitrovicës.

Kushtet e këqija ekonomike, fatkeqësitë natyrore ose konfliktet e armatosura, rrethanat komplekse politike dhe sociale të individëve apo grupeve, dhe faktorë të tjerë të ndryshëm të përbashkët shtytës kanë qenë shkaku themelor për natyrën kalimtare të lëvizjes së popullsisë emigrante nëpër Kosovë dhe në BE. Stafi i angazhuar në hulumtim shqyrtoi procesin e reagimit të Kosovës në ofrimin e mbështetjes për emigrantët e huaj dhe azilkërkuesit në rajonin e Mitrovicës duke analizuar gatishmërinë institucionale të Kosovës dhe ndërhyrjet e mekanizmave të themeluar mbështetës në formë të strehimit, edukimit, ndihmës mjekësore dhe shërbimeve të nevojshme sociale, së bashku me dinamikën e rrugës kosovare dhe profilin demografik të migrantëve.

METODOLOGJIA

Nevojat e hulumtimit janë përmbushur përmes aktiviteteve kërkimore parësore dhe dytësore, me informacion thelbësor të mbledhur vetëm për qëllimin e këtij hulumtimi. Stafi i angazhuar në hulumtim mbledhi të dhëna në mënyrë transparente dhe objektive, duke i kushtuar vëmendje të veçantë të drejtave të njeriut të individëve emigrantë dhe duke u fokusuar në natyrën komplekse të lëvizjes bashkëkohore të emigrantëve në rajon, duke respektuar dinjitetin njerëzor dhe të drejtën e privatësisë së individëve, duke siguruar anonimitet të të dhënave në mënyrë që identitetet e individëve të mbledhur gjatë aktiviteteve kërkimore parësore nuk janë më të identifikueshme ose të dhëna të tilla nuk konsiderohen më si të dhëna personale.

Intervistat gjysmë të strukturuar me emigrantët dhe palët e ndryshme të interesit dhe përfaqësuesit e sektorit të OJQ-ve në rajonin e Mitrovicës u zhvilluan në periudhën nga 1 tetori deri më 15 nëntor 2021, dhe shërbyen si bazë empirike e studimit hulumtues.

Akterët e mëposhtëm vendorë dhe ndërkombëtarë janë konsultuar për të fituar një kuptim solid të gjendjes në lidhje me emigrantët në Ballkanin Perëndimor dhe Kosovë: Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) në Kosovë, Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM), Zyra e Shërbimit Jezuit për Refugjatët (JRS) në Kosovë dhe Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës (MPB Kosovë). Kontributi i tyre dhe koha e ndarë vlerësohen shumë pasi u siguruanjë analizë e plotë e fenomenit të migrimit dhe faktorëve përkatës që shtojnë apo tërheqin (push-pull) lëvizjen e popullsisë. Çështjet kryesore që stafi hulumtues ka hasur gjatë aktiviteteve kërkimore operacionale kanë qenë të lidhura me natyrën dinamike të lëvizjes së popullsisë migruese për t'u intervistuar, që nënkupton vështirësi në realizimin e intervistave të hollësishme, pamundësi për të mbajtur kontakte dhe ndjekur veprimet e tyre për shkak të lëvizjeve të vazhdueshmetë tyre.

Të dhënat parësore kërkimore janë mbledhur në pikat e nisjes dhe rrugët kryesore të përdorura nga individë të përfshirë drejtpërdrejt në lëvizje (emigrantë) ose nga ata që tregojnë tendenca të tilla (vëzhguesit), duke pasur ndërveprim të dorës së parë apo edhe komunikim me emigrantët. Është përshtatur një qasje cilësore (intervistë gjysmë e strukturuar) si një mënyrë për të mbështetur mbledhjen, analizën dhe raportimin e duhur të të dhënave, me stafin hulumtues për të identifikuar sfidat me të cilat përballen migrantët përmes pyetjeve të bazuara në temë, dëgjimit të të anketuarve dhe nxënies së shenjave, diskutimit për temë pa ndërprerje ose udhëzime. Intervistat e realizuara në këtë mënyrë rezultuan të kenë dhënë informacion të detajuar, duke mbuluar një gamë të gjerë temash interesante, me të anketuarit që ngritën pikat e rëndësishme për ta, duke i zbuluar të dhënat e detajuara dhe shpesh të ndjeshme për intervistuesit.

Të dhënat dytësore kërkimore janë mbledhur nga burimet e të dhënave të disponueshme në nivel kombëtar përmes burimeve të identifikueshme të njohurive, siç janë të dhënat përkatëse zyrtare qeveritare dhe joqeveritare (përfshirë shifrat zyrtare të migracionit dhe azilit), mbulimet nga mediat sociale dhe gazetat. Bazuar në gjetjet e tij, studimi hulumtues ofroi zgjidhje korigjuese në adresimin e çështjeve me të cilat përballen emigrantët në Kosovë dhe rajonin e saj verior të Mitrovicës, një sërë rekomandimesh dhe veprimesh korigjuese që mund të ndërmerren nga institucionet.

IDENTIFIKIMI I PROBLEMIT

Vendet e Ballkanit Perëndimor gjithmonë kanë qenë vetëm një stacion kalimtar për emigrantët, në vend të destinacionit të tyre përfundimtar, duke sjellë kështu vështirësi dhe sfida në trajtimin e "mysafirëve të papritur", që kalojnë transit nëpër territoret e tyre në kuptim të mbështetjes institucionale dhe ofrimit të të drejtave themelore të njeriut. Vendet e Ballkanit Perëndimor me qetësi janë përballur me migracionin ndërkombëtar, duke shërbyer kryesisht si korridor për emigrantët drejt vendeve evropiane. Një numër i parëndësishëm emigrantësh vendosin të kërkojnë azil në Ballkanin Perëndimor, vetëm sa për të zgjatur udhëtimin e tyre për disa javë/muaj dhe konsoliduar përpjekjet e tyre për të ndjekur qëllimin përfundimtar të azil kërkimit në Evropë.

Kosova ka tri (3) qendra pranuese për azilkërkuesit dhe së fundmi ka filluar të merret me këtë çështje, ngase deri në vitin 2009, merrej kryesisht me të kthyerit e saj që u larguan nga vendi para dhe gjatë luftës në vitin 1999. Ka pak hulumtime që mbështesin mbështetjen operative të Kosovës për emigrantët, strategjinë e saj për migrim, qasjen institucionale si për nga objektet infrastrukturorë në dispozicion dhe rregullimin e politikave. Ky raport synon të japë një pamje të gatishmërisë së vendit për t'u përballuar me emigrantët, të manifestuar në mbështetjen institucionale qeveritare dhe joqeveritare në përmbushjen e standardeve ndërkombëtare për mbrojtjen e emigrantëve dhe azilkërkuesve.

Marrë parasysh këtë, tek identifikimi i problemit fokusohemi në përcaktimin e mbështetjes socio-ekonomike që marrin dhe sfidave me të cilat përballen azilkërkuesit gjatë qëndrimit në rajonin e Kosovës/Mitrovicës, dhe se si autoritetet e trajtojnë çështjen e migrimit.

Pyetjet e hulumtimit fokusohen në situatën aktuale me emigrantët në Kosovë, shpërndarjen hapësinore dhe gjendjen e migrimit në rajonin e Mitrovicës, dhe akterët kryesorë institucionalë dhe të tjerë të përfshirë në ofrimin e shërbimeve dhe/ose ndihmës për migrantët dhe azilkërkuesit e huaj në rajonin e Mitrovicës?

Situata e migrimit në rajonin e Ballkanit Perëndimor/ Kosovë/Mitrovicë?

Janë dy rrugë të rëndësishme që përdoren nga refugjatët dhe emigrantët që udhëtojnë drejt Evropës, rruga e **Ballkanit Perëndimor** dhe rrugët **trans-mesdhetare**. Rruga e **Ballkanit Perëndimor** është rruga më e përdorur nga emigrantët që udhëtojnë nga Siria, Iraku, Irani, Afganistani dhe Pakistani. Tri rrugët **trans-mesdhetare** (lindore, qendrore dhe perëndimore) përdoren kryesisht nga emigrantët e shteteve të Afrikës. Megjithatë, rruga e **Ballkanit Perëndimor** mbetet më dominuesja për shkak të udhëtimit përmes rrugës tokësore dhe, rrjedhimisht, rrugës më të sigurt e me më pak viktime. Në të kundërt, rrugët mesdhetare kanë një probabilitet të rritur të fatalitetit për shkak të udhëtimit në det, zakonisht në anije të mbingarkuara të ndërtuara nga poliuretani ose anije peshkimi me strukturë të dobët druri. Sipas IOM[1], rastet me fatalitet dhe personat e zhdukur në rrugët mesdhetare në periudhën 2014-2018 arritën në rreth 18000 persona. Të dhënat për vitin 2021 (janar – shtator) tregojnë për 1369 viktime në rrugën e Mesdheut, që nga ky shkrim.

Republika e Turqisë është një qendër e migrimit në Lindjen e Mesme dhe një destinacion i përbashkët për migrantët që udhëtojnë në Evropë dhe vendi fillestar i migrimit i zgjedhur për emigrantë të shumtë nga Lindja e Mesme për shkak të rrethit dhe agjendës gjeopolitike, kufirit me vendet me konflikt të hapur, si Siria dhe Iraku. Emigrantët fillimisht hyjnë në Turqi dhe më pas përpiqen të shkojnë në Evropë, në Greqi përmes detit Egje ose në Bullgari. Megjithatë, duke qenë se shumica e tyre nuk kanë ndërmend të qëndrojnë as në Evropën Jugore apo Lindore, lëvizin drejt vendeve të Evropës Perëndimore nëpërmjet Ballkanit Perëndimor. Arsyeja pse emigrantët vendosin të mos qëndrojnë në vendet jugore/lindore të BE-së si Bullgaria apo Greqia dhe të kërkojnë azil atje qëndron në Rregulloren e Dublinit (1990), një marrëveshje e nënshkruar nga vendet e BE-së, Zvicra, Lihtenshtajni, Norvegjia dhe Islanda, rregullore e cila përcakton se azilkërkuessit duhet të qëndrojnë në vendin e parë evropian ku hyjnë dhe se ky vend do të jetë përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës së tyre për azil, duke i penguar ata të udhëtojnë në një vend të preferuar të tyre (në shumicën e rasteve disa nga vendet e Evropës Perëndimore). Një arsye tjetër përse emigrantët preferojnë të mos qëndrojnë në vendet e Evropës Jugore/Lindore dhe të kërkojnë azil janë kushtet jo të mira të mirëqenies dhe armiqësia ndaj tyre, e cila është jashtëzakonisht e lartë në Evropën Lindore.

Ballkani Perëndimor është një rrugë e rëndësishme për emigrantët në rrugëtimin e tyre drejt Evropës për shkak të afërsisë së tij me zonën Shengen si dhe është një rrugë më e sigurt transiti për në vendet e BE-së të pasura me mirëqenie, kushte jetese dhe ku mundësia për azil për bashkim familjar ofrohet.

Shumica e emigrantëve e nisin udhëtimin e tyre në Turqi dhe më pas vazhdojnë në Bullgari, Rumania ose Greqi, pastaj përmes Ballkanit Perëndimor vazhdojnë në Hungari ose Kroaci. Tendencat e lëvizshmërisë së emigrantëve tregojnë se shumica e tyre që kalojnë transit nëpër rajonin e Ballkanit Perëndimor po lëvizin drejt Malit të Zi, Bosnje e Hercegovinës dhe Serbisë dhe më tej drejt Kroacisë, Rumanisë dhe Hungarisë. Në Kosovë kryqëzohen korridoret e transitit nga Maqedonia e Veriut, Greqia dhe Shqipëria.

Tabela 1: Azilkërkuksit dhe lëvizjet e tjera të përzicra në Ballkanin Perëndimor, 2015–2020;

Burimi: Raportet e UNHCR-së për refugjatët

SHTETI	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Shqipëria	2047	915	1049	5730	10561	11971
Bosnja	133	766	4489	23902	29196	16211
Kosova	N/A	16	147	590	2081	1910
Mali i Zi	N/A	167	807	4753	8695	2898
Maqedonia e Veriut	428597	127358	4129	16895	40887	41257
Serbia	579518	60000	69900	45400	30419	39648

Kosova

Kosova është një pikë tjetër tërheqëse për emigrantët ndërkombëtarë në rrugën e Ballkanit Perëndimor, që kryesisht përdoret si zonë transiti për në Evropë për shkak të pozitës së saj të favorshme gjeografike dhe potencialit për të arritur shpejt në vende të tjera. Emigrantët kalojnë në rrugët e pa miratuar nga Shqipëria ose Maqedonia e Veriut dhe hyjnë në Kosovë ose në këmbë, me autostop, ose duke paguar taksit/autobus deri tek kufiri me Kosovën, përmes shtigjeve alternative, duke anashkaluar vendkalimet zyrtare në Han të Elezit dhe Vërmicë.

Strukturat dhe agjencitë e zbatimit të ligjit në Kosovë – policia kufitare, dogana dhe shërbimet e emigracionit janë përgjegjëse për menaxhimin e duhur dhe efektiv të kufirit. Ata regjistrojnë hyrjen e mallrave dhe njerëzve në vendkalimet zyrtare kufitare, punojnë në zbulimin e tentativave të kontrabandës së mallrave të paligjshme dhe kontrabandës me njerëz, dhe parandalojnë kontrabandën e emigrantëve dhe forcojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut të emigrantëve.

Agjencitë e përmendura janë pika e parë e kontaktit për emigrantët ndërkom-bëtarë; bashkëpunojnë ngushtë me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migracion (DSHAM) në të gjitha rastet e emigrimit të paligjshëm dhe trafikimit të qenieve njerëzore. Agjencitë ndjekin procedurat e vendosura operative për trajtimin dhe dallimin ndërmjet rasteve të migrimit të paligjshëm dhe trafikimit/kontrabandimit të qenieve njerëzore. Megjithatë, kushtet që përmbushen nga azilkërkuesit dhe emigrantët duhet të dallohen. Ata individë që kërkojnë azil, me të hyrë në territorin e Kosovës, bëhen azilkërkues të kualifikuar për strehim në një nga qendrat ekzistuese pranuese, me përfitime si strehim, ushqim, ndihmë mjekësore dhe juridike. Në të njëjtën kohë, ata që vendosin të vazhdojnë udhëtimin e tyre konsiderohen si emigrantë dhe shpesh përfundojnë duke jetuar në apartamente me qira, të mbipopulluara, apo edhe në rrugë, duke qenë të pambrojtur dhe të prirur për shfrytëzim ndaj rrjeteve të kontrabandistëve.

Me takimin e tyre të parë me forcat e rendit, migrantët dërgohen në stacionin më të afërt të policisë, nga ku Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion (DSHAM) merr përsipër procedurën e identifikimit, duke marrë të dhënat e tyre personale, fotografitë dhe shenjat e gishtërinjve. Pas procedurës së identifikimit, DSHAM i përcjell migrantët më tej brenda vendit në qendrat pranuese në Magurë, Vranidoll ose Mitrovicë.

Ministria e Punëve të Brendshme, brenda shtatë ditëve ua siguron atyre një dokument të përkohshëm identifikimi për të lëvizur lirshëm brenda vendit. Numri i azilkërkuesve u rrit me shpejtësi në vitin 2020, duke e detyruar DSHAM-në të përshtatet me situatën e krijuar rishtazi dhe përveç objektit pranues në Vranidoll të rrisë kapacitetet e tyre akomoduese. Departamenti hapi qendrat pranuese në Magurë dhe Mitrovicë. Qendra pranuese në Mitrovicë ishte funksionale vetëm për dy (2) muaj, dhe u mbyll për shkak të trazirave mes migrantëve të cilët i vënë flakën, duke lënë të lënduar gjashtë (6) persona¹. Kjo qendër për azil është e mbyllur pasi që dy (2) qendrat e tjera kanë kapacitet të mjaftueshëm akomodues.

Emigrantëve në Kosovë që i nënshtrohen procedurës për azil kërkim u ofrohet strehim, ushqim dhe shërbime mjekësore, mirëpo mbrojtja e tyre institucionale mbetet e pazgjidhur. Të miturit dhe gratë janë në rrezik më të madh për t'u bërë viktime të abuzimit seksual, trafikimit të qenieve njerëzore dhe kontrabandës. Shumë vepra penale mbeten të pa denoncuara nga frika e hakmar-rjes, ndërkohë që policia reagon vetëm për ato krime të denoncuara.

Në vitin 2020, azil në Kosovë kanë kërkuar 803 persona, 85 gra dhe 120 fëmijë², por shumica u larguan pas parashtrimit së kërkesës për azil. Shumica e azilkërkuesve nuk kanë për qëllim që të qëndrojnë për një kohë të gjatë në

¹ Digjet një kamp refugjatësh në Mitrovicë, shkurt 2021, RTV21, marrë nga:
1. <https://rtv21.tv/perfshihet-nga-zjarri-nje-kamp-refugjatesh-ne-mitrovice/>
2. *AYS Daily Digest 28/1/21: Fire in a refugee camp in Kosovo leaves six injured | by Are You Syrious? | Are You Syrious? | Medium*

² UN Agencies' attention on conditions of asylum-seekers in Kosovo, UNICEF, marrë nga:
<https://www.unicef.org/kosovoprogramme/press-releases/un-agencies%C2%B4-attention-conditions-asylum-seekers-kosovo>

qendrat pranuese në Kosovë. Sipas informacionit të marrë gjatë aktiviteteve kërkimore parësore, një numër i konsiderueshëm i emigrantëve aplikojnë për azil vetëm për të zgjatur qëndrimin e tyre ligjor, zakonisht rreth 3 – 4 javë. Pas kësaj periudhe, largohen në drejtim të panjohur, pa asnjë njoftim. Shumica e migrantëve udhëtojnë në komunën e Vushtrrisë, dhe prej aty, marrin taksì ose ecin drejt qytetit të Mitrovicës dhe më pas shkojnë më tej në komunat veriore duke kaluar kufirin me Serbinë.

Demografia (azilkërkuesit në Kosovë)

Sipas statistikave të marra nga Ministria e Punëve të Brendshme, numri i azilkërkuesve në Kosovë në vitin 2019 ishte 2081, që është një rritje për më shumë se tre herë krahasuar me vitin paraprak 2018 (595), pasuar me një rënie të lehtë në vitin 2020 me 1409 azilkërkues të raportuar.

Tabela 2. Vendi i origjinës së emigrantëve (2019/2020)

Burimi: Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion (DSHAM), Ministria e Punëve të Brendshme, Kosovë

VENDI I ORIGJINËS	2019	VENDI I ORIGJINËS	2020
Siria	911 (43.8%)	Siria	649 (46.1%)
Iraku	559 (26.9%)	Maroku	649 (46.1%)
Maroku	152 (7.3%)	Palestina	121 (8.6%)
Algjeria	152 (7.3%)	Iraku	119 (8.4%)
Palestina	152 (7.3%)	Libia	89 (6.3%)
Shtete te tjera	152 (7.3%)	Shtete te tjera	248 (17.6%)

Grup mosha më e përfaqësuar në vitin 2019 ishte 18-34 vjeç me 66,2%, e ndjekur nga 35-64 vjeç me 13,9%, 0-13 vjeç me 15,6%, grup mosha 14-17 vjeç me 4,1% dhe 65 + me 0,2 %.

Në vitin 2020 kishte 1409 azilkërkues, 1261 (89.5%) meshkuj dhe 148 (10.5%) gra. Nga ata 1409, 887 persona kanë hyrë ilegalisht në territorin e Kosovës, 20 prej tyre kanë hyrë legalisht, ndërsa mbetet e paqartë se si kanë hyrë 502 persona.

Tabcla 3. Hyrja e emigrantëve në Kosovë (2020)

Burimi: Dcpartamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion (DSHAM), Ministria e Punëve të Brendshme, Kosovë

MËNYRA E HYRJES	NUMRI (PERSONA)
Ilegale	502
Legale	887
E panjohur	20
TOTALI	1409

Tabcla 4. Hyrja e azilkërkuesve në pikat kufitare (2019/2020)

Burimi: Dcpartamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion (DSHAM), Ministria e Punëve të Brendshme, Kosovë

PIKAT KUFITARE HYRËSE	NUMRI (PERSONA)
Shqipëria	1232
Maqedonia e Veriut	46
Serbia	99
Mali i Zi	1
Aeroporti "Adem Jashari" – Pr.	15
E panjohur	16
TOTALI	1409

Gjatë periudhës 2019/2020, ka pasur një rritje të ndjeshme të numrit të azilkërkuesve të moshës 0-13 vjeç, kryesisht të shoqëruar nga familjarët e tyre, si rezultat i situatës së përgjithshme dhe lëvizjeve të emigrantëve nga vendet e Lindjes së Mesme.

Sipas gjinisë, meshkujt dominuan me 82% ndërsa gratë përfaqësoheshin me 18%.

Gjatë vitit 2019 janë dhënë 1.924 vendime të shkallës së parë për statusin e azilkërkuetit: në 89.7% (1.867) raste procedura është ndërprerë; 1.3% (27) e aplikantëve kanë marrë vendim të përhershëm të favorshëm; 1.3% (27) e aplikantëve e kanë ndërprerë procedurën vullnetarisht; kërkesa për azil është refuzuar për 0,10 % (2) të individëve; 0.05% (1) kërkesa për azil është refuzuar sipas procedurës së përshpejtuar; 6.8% (141) e kërkesave ishin ende në fazën e aplikimit, dhe 0.77% (16) e kërkesave ishin ende në pritje të vendimit.

Kontrabandimi i emigrantëve

Kontrabandimi i emigrantëve në Kosovë paraqet një kërcënim të madh për sigurinë e përgjithshme. Rrjetet kriminale shfrytëzojnë dobësitë e emigrantëve dhe synimin e tyre për të arritur në BE sa më shpejt të jetë e mundur. Duhet marrë parasysh se rruga e Ballkanit Perëndimor konsiderohet një rrugë me buxhet të ulët dhe është vetëm një pjesë e një rruge shumë më të gjatë.

Tabela 5: Rastet e kontrabandës së emigrantëve nën hetim në Kosovë 2016 - 2018;

Burimi: Njësia e Analizës së Riskut, Inteljigjencës dhe Administrimit të të Dhënave, Departamenti për Kufi, Drejtoria për Hetimin e Krimin të Organizuar, Policia e Kosovës

	2016	2017	2018	TOTAL
Kosovë	15	27	12	54
Shqipëri	8	1	5	14
Serbia	3	1	2	6
Turqia	0	1	1	2
Maqedonia e Veriut	0	1	0	1
TOTALI	26	31	20	77

Në vitin 2018, ka pasur një rënie prej 17% në hetimin e rasteve të kontrabandës së emigrantëve në krahasim me vitin 2017, ndërsa në vitin 2016 është vërejtur një rritje prej 41%.

Gjatë vitit 2018, numri i personave të dyshuar për kontrabandë me emigrantë ishte më i ulët për 35% krahasuar me vitin 2017, ose më i ulët me 23% krahasuar me vitin 2016. Nga 77 personat e dyshuar për kontrabandë të emigrantëve, 70% ishin shtetas të Republikës së Kosovës, 18% të Republikës së Shqipërisë, 8% të Serbisë, 3% të Turqisë dhe 1% të Maqedonisë së Veriut.

Për shkak të natyrës konfidenciale, stafi hulumtues nuk ishte në gjendje të merrte informacione për kontrabandimin e emigrantëve për rajonin e Mitrovicës. Stacioni i PK-së në Mitrovicën e Jugut dhe Njësia e Hetimeve Rajonale Mitrovica-Jug janë kontaktuar përmes njësive/departamenteve përkatëse, por nuk kanë qenë të gatshëm të ndajnë ndonjë informacion.

Mitrovica

Shpërndarja hapësinore e migrantëve që nuk janë akomoduar në qendrat pranuese dhe nuk kanë aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare pranë institucioneve të Kosovës është tipike për modelet e lëvizshmërisë së emigrantëve. Në hyrje dhe dalje të përqendruar, ata lëvizin përgjatë korridoreve infrastrukturale si rrugët, hekurudhat, lumenjtë dhe vendet e shkëmbimit të popullsisë, duke shkuar në drejtimin të veriut drejt kufirit me Serbinë.

Në përpjekje për të mbledhur dëshmi sistematike të shtetasve të huaj dhe emigrantëve që udhëtojnë nëpër rajonin e Mitrovicës, jashtë qendrave pranuese, dhe për të regjistruar lëvizjen dhe zhvendosjen e tyre, stafi i angazhuar në hulimtim u konsultua me autoritetet lokale (punonjësit e DSHAM-it) dhe agjencitë e zbatimit të ligjit (Stacioni i Policisë Jug - zyrtarët policorë të Njesisë së Policisë në Komunitet dhe Policisë Kufitare Veri) në lokacionet më të shpeshta në Mitrovicë të vizituara nga emigrantët. Stafi hulumtues është këshilluar që emigrantët më së shpeshti mund të vërehen tek stacioni i autobusëve në jug, stacionet e taksive (si në Mitrovicën e Jugut ashtu edhe të Veriut), tek hekurudha që lidh jugun me veriun, në një lagje në Mitrovicë të njohur si Lagja e Boshnjakeve, dhe më tej në veri përgjatë kufirit/pikës kufitare me Serbinë - Porta 1/Jarinje.

Gjatë periudhës raportuese, stafi hulumtues realizoj pesë (5) vizita të grupeve të emigrantëve:

- Vizitë e një grupi prej dymbëdhjetë (12) meshkujsh të rritur, të moshës tetëmbëdhjetë deri në tridhjetë e pesë (18 - 35) vjeç, të shoqëruar nga një grua më e re, të gjithë me rroba dimri, me çanta shpine dhe çanta gjumi, duke ecur nëpër **binarëte hekurudhës në Mitrovicë e Jugut** (afër stacionit hekurudhor) në drejtim të veriut.
- Vizitëe një grupi migrantësh, prej rreth pesëmbëdhjetë deri në njëzet (15 - 20) meshkuj të rritur, të moshës tetëmbëdhjetë deri në dyzet (18 - 40) vjeç, rroba dimri, çanta shpine, çanta gjumi, në afërsi të **Stacionit hekurudhor në Zveçan (afër Trepçës)**, duke shkruar në drejtim të veriut.
- Vizitëe një grupi prej rreth dhjetë deri në pesëmbëdhjetë (10 - 15) meshkuj të rritur, njëzet deri në dyzet (20 - 40) vjeç, rroba dimri, çanta shpine, **në qendër të Mitrovicës së Jugut (Zyrat e IPKO-s)**, duke shkruar në drejtim të veriut.

- Vizitëe një grupi prej pesë (5) meshkujsh të rritur, mjaft të rinj për nga pamja, përfaqësisht 20-25 vjeç, pa çanta shpine/valixhe/çanta gjumi, të veshur lehtë, janë vërejtur duke dalë nga një furrë buke në një lagje të Mitrovicës, të njohur si **Lagja e Boshnjakëve**, duke shkruar në drejtim të veriut.
- Vizitëe një grupi prej përfaqësisht dhjetë (10) meshkujsh të rritur, njëzet deri në dyzet (20 – 40) vjeç, me rroba dimri, çanta shpine, **në qendër të Mitrovicës së Jugut** (në afërsi të **Qendrës tregtare LUX**), duke shkruar në drejtim të veriut.

Stafi hulumtues u përpoq të kontaktonte këto grupe në lokacionet e identifikuar dhe t'i intervistonte ato, por dështoi në tre (3) nga pesë (5) raste. Arsyeja e dështimit ishte kryesisht pengesa gjuhësore, mungesa e aftësisë, apo edhe gatishmëria e migrantëve për të diskutuar udhëtimin e tyre në lingua franca (një gjuhë ure - në rastin tonë anglishtja). Shumica prej tyre nuk zotëronin asnjë njohuri të gjuhës angleze, duke lënë stafin hulumtues pa ndonjë zgjidhje tjetër veçse të lë atë mundësi. Vështirësitë gjuhësore mund të çojnë potencialisht në mungesë ose komunikim të dobët dhe të duhur të nevojave të tyre; prandaj, stafi hulumtues nuk i ka ndjekur më tej këto tre (3) gjurmë tjera.

Stafi hulumtues vendosi kontakte me 2 (dy) grupe emigrantësh dhe kreu intervista gjysmë të strukturuar grupore. Takimi i parë ishte në binarët e hekurudhës në **Mitrovicën e Jugut**, në afërsi të Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicë **IBC-M** dhe **stacionit hekurudhor**. Grupi përbëhej nga dhjetë deri në dymbëdhjetë (10-12) individë meshkuj të rritur, të moshës 20 – 40 vjeç. Si pjesë e grupit të parë ishte identifikuar një zonjë e vetme që ecte përgjatë binarëve të hekurudhës. Ajo dukej mjaft e re, rreth 20-25 vjeç, shumë e rezervuar dhe me hapësirë të dukshme personale mes saj dhe pjesës tjetër të grupit.

Pjesa tjetër e meshkujve të këtij grupi ishin të rinj të moshës madhore dhe ata ndanë pritshmëritë për të "përfunduar në Evropën Perëndimore". Grupit i është thënë të ndjekë binarët e hekurudhës, që do i çojnë përfundimisht në Serbi. Shumica që nisën udhëtimin e tyre në Turqiishin nga Siria. Një mashkull i rritur nga Siria konsiderohej lider, me sa duket për shkak të aftësive të tij të komunikimit në gjuhën angleze. U parashtruan një sërë pyetjesh për modalitetet e udhëtimit të tyre deri në këtë pikë, dhe ai shpjegoi se ata hynë në Shqipëri me anije, më pas kaluan në Kosovë, duke udhëtuar në këmbë natën ose në orët e hershme të mëngjesit, për t'iu shmangur organeve të rendit. Ata nuk u regjistruan në qendrat pranuese në Kosovë dhe po shkonin në Serbi; duke folur për veten e tij, ai tha: "Së shpejti, do të jem në Holandë". Veshjet e grupit ishin të papastra, këpucët e vjetërsuara; megjithatë, grupi dukej i ushqyer dhe me shëndet të mirë. Një sërë tjetër pyetjesh u parashtruar në lidhje me problemet me të cilat ata janë përballur gjatë gjithë rrugëtimit. Ata theksuan aspektin financiar si më të rëndësishmin për të qëndruar në lëvizje, më pas qasjen në ujë të pastër dhe ushqim, si dhe ndihmën mjekësore,

pasi një nga anëtarët e grupit që kishte simptoma të ngjashme me COVID-in duhej të qëndronte në Shqipëri. Intervista zgjati 20 minuta dhe duke gjykuar nga ndërveprimi verbal dhe indikacionet jo verbale, pamja, toni i zërit të tyre, anëtarët e grupit ndiheshin rehat me njëri-tjetrin, nuk kishte asnjë shenjë armiqësie mes tyre teksa diskutonin intervistën në praninë tonë, dukeshin të relaksuar dhe optimistë për rezultatin e rrugëtimit të tyre.

Grupit të dytë të vëzhguar të emigrantëve iu është qasur në anën veriore të **Urës Lindore, tek Lagja e Boshnjakëve** - pjesë e qytetit. Ky grup përbëhej nga individë të rinj meshkuj në moshë madhore pa lider të dukshëm. Grupi numëroi dhjetë (10) individë meshkuj të moshës madhore, afërsisht 20 – 40 vjeç. Vetëm dy (2) individë nga grupi zotëronin disa njohuri të gjuhës angleze dhe me aftësi për t'u shprehur në mënyrë të qartë, koncize, të kuptueshme për stafin hulumtues. Në një sërë pyetjesh mbi modalitetet e udhëtimit të tyre deri në këtë pikë, njëri nga të dy shpjegoi se shumica e anëtarëve të grupit kaluan pak kohë në qendrën pranuese në Vranidoll megjithatë, vendosën të mos qëndrojnë më në Kosovë, por në vend të kësaj të ndjekin qëllimin e tyre përfundimtar dhe të kërkojnë azil në vendet e BE-së. Disa anëtarë të grupit refuzuan të regjistroheshin në qendrat e regjistrimit të Kosovës, dhe kështu jetonin në akomodime private, hostele ose ndërtesa të braktisura. Ashtu si në grupin e parë, anëtarët e grupit ishin familjarizuar dhe ndiheshin rehat me njëri-tjetrin. Ata udhëtonin natën, për të mos u vërejtur nga policia, flinin në thasë gjumi dhe nën tenda të improvizuara. Po ashtu, për disa prej tyre kjo ishte përpjekja e dytë për të hyrë në BE. Në një grup tjetër pyetjesh në lidhje me problemet me të cilat janë përballur gjatë udhëtimit të tyre, ata u përgjigjën se prioritet ka qenë gjithmonë siguria tyre, si dhe problemi i karikimit të celularëve, si një çështje e rëndësishme pasi janë përpjekur të mbajnë kontakte me anëtarët e familjes së tyre duke i njoftuar ata për mirëqenien e tyre, por edhe duke përdorur GPS e telefonave celularë për qëllime navigimi, duke përcaktuar vendndodhjen e tyre të saktë në kohë reale dhe duke gjetur rrugë nëpër pyje dhe rrugë e shtigje më pak të kalueshme. Një nga migrantët komentoji mbathjet e tyre, duke thënë se atyre u duhen këpucë pasi konsumohen shpejt për shkak të lëvizjes së madhe. Mungesa e ushqimit dhe financave janë përmendur si aspekte të rëndësishme të rrugëtimit të tyre.

Në kërkim të përgjigjeve për çështjet që kanë të bëjnë me migrimin dhe sistemin e azilit në Mitrovicë, stafi hulumtues mësoi se i gjithë sistemi është i centralizuar dhe menaxhohet nga Ministria e Punëve të Brendshme. Të gjithë përfaqësuesit e intervistuar të institucioneve pohuan se nuk posedonin informacion apo dokumentacion për rajonin e Mitrovicës pasi që kampi ishte funksional vetëm për një kohë të shkurtër.

Ministria caktoi një koordinator rajonal në Mitrovicë për të lehtësuar komunikimin me institucionet komunale për çështjet e migrimit. Qendra pranuese në kampin Belvedere (PK ROSU - Njësi Rajonale e Mbështetjes Operative) në Mitrovicën e Jugut ka funksionuar vetëm për dy muaj, nga nëntori 2020 deri në janar 2021, dhe është mbyllur siç mësuam për shkak të përleshjeve të vazhdueshme ndërmjet grupeve të emigrantëve nga Maroku dhe Siria. Ata madje

arritën t'i vënë flakë një qendre, pastaj autoritetet vendosën të transferojnë të gjithë azilkërkuesit në një nga objektet në Vranidoll dhe Magurë. Në përgjithësi, rajoni i Mitrovicës përdoret kryesisht si një transit për emigrantët për të arritur deri në pikën kufitare në Portën 1 (Jarinjë) dhe për të lëvizur më tej në Serbi. Policia e Kosovës pas identifikimit të tyre në këtë rajon i dërgon në Stacionin Policor të Mitrovicës Jugore për mbledhjen e të gjitha informatave lidhur me origjinën dhe qëllimin e tyre. Pastaj, ata që vendosin të aplikojnë për azil trajtohen nga një përfaqësues i DSHAM-së, i cili nis procesin e strehimit në qendrat e azilit në Vranidoll ose Magurë. Së fundmi nuk ka pasur raste të dërgimit të azilkërkuesve në strehimore në kampin Belvedere direkt nga Stacioni Policor i Mitrovicës së Jugut.

Mbështetja institucionale në rajonin e Mitrovicës

Për një periudhë të konsiderueshme organizatat ndërkombëtare kanë punuar rreth çështjeve të migrimit dhe azilkërkimit në mbarë botën. Organizatat ndërkombëtare si Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) dhe Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR) me vite kanë qenë gjithmonë të përfshira në mbledhjen e informacionit të rëndësishëm mbi të drejtat themelore që emigrantët duhet të kenë që nga momenti kur ata largohen nga vendet e tyre dhe hyjnë në territor/vend të ri. Puna e tyre është në përputhje me të drejtën ndërkombëtare për migracion (DNM), duke mbështetur e synuar plotësimin e boshllëqeve në legjislacionin dhe aktivitetet e secilit vend dhe përvetësuar aspektet kritike të DNM-së.

Me rastet e para të raportuara të migrimit ndërkombëtar, Qeveria e Kosovës themeloi **Departamentin e Shtetësisë, Azilit dhe Migracionit (DSHAM)**, që vepron nën ombrellën e **Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB)**. Niveli i qeverisjes së këtij departamenti është ende i centralizuar, **DSHAM** emëroi koordinatorin rajonal për secilin rajon të Kosovës që vepron në kuadër të Zyrës Komonale për Komunitete dhe Kthim në komunën kryesore. Në Mitrovicë, z. Fisnik Leku shërben si Koordinator rajonal, detyra kryesore e të cilit është të lehtësojë komunikimin në mes të MPB/DSHAM me akterët që punojnë në fushën e migracionit.

DSHAM përbëhet nga divizione të ndryshme, duke përfshirë Divizionin për Azil dhe Qendrën e Azilkërkuesve. Ky divizion punon në mënyrë eksplicite me emigrantët dhe azilkërkuesit e huaj dhe mbarvan funksionalitetin e qendrave pranuese për azilkërkuesit. Ekipi i DSHAM-së mbledh, analizon dhe vlerëson informacionin në lidhje me emigrantët dhe azilkërkuesit. Zhvillon dhe përditëson strategjitë operative, planet e veprimit dhe politikat në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin Ligjor. Gjithashtu, ka një përgjegjësi thelbësore në përpunimin e kërkesave për azil dhe menaxhimin e qendrave pranuese.

Ministria e Punëve të Brendshme ka kontraktuar kompani për të ofruar shërbime ushqimore, sanitare, mjekësore dhe shërbime të tjera të nevojshme, duke përfshirë mbështetjen ligjore dhe financiare për azilkërkuesit. Përveç financimit publik, organizatat ndërkombëtare mbështetëse ofrojnë mbështetje financiare shtesë për të plotësuar boshllëqet. Në të vërtetë, përfshirja e akterëve të tjerë luan një rol vendimtar në menaxhimin e duhur të proceseve të migracionit dhe azilkërkimit. Përveç DSHAM-së, akterët kryesorë të përfshirë në ofrimin e shërbimeve dhe asistencës për emigrantët e huaj dhe azilkërkuesit në Rajonin e Mitrovicës janë si në vijim: Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM), Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) në Kosovë, Zyra e Shërbimit Jezuit për Refugjatët (JRS) në Kosovë, Programi për të Drejtat Civile në Kosovë (CRPK) dhe Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT). Secila prej këtyre organizatave ka një rol të ndryshëm në mbështetjen e qëndrimit të emigrantëve dhe azilkërkuesve në Kosovë.

Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM)

IOM është organizata lidere në botë që merret me migracionin. IOM në Kosovë ka funksionuar që nga viti 1999 duke u marrë fillimisht me personat e zhvendosur, të kthyerit dhe minoritetet me qëllim të sigurimit të stabilitetit në komunitet. IOM-i e kryen mandatin e saj sipas rregulloreve ndërkombëtare dhe të Drejtës Ndërkombëtare për Migracion (DNK). IOM Kosova është pjesë e dy projekteve rajonale nën portofolin e Imigrimit dhe Menaxhimit Kufitar, përkatësisht "Menaxhimi i Fluksit jo të Rregullt Migrator në Ballkanin Perëndimor" dhe "Forcimi i bashkëpunimit midis zyrtarëve të zbatimit të ligjit". Aktualisht, projekti "Adresimi i sfidave të COVID-19 në kuadër të reagimit ndaj migrantëve dhe refugjatëve në Ballkanin Perëndimor", po zbatohet nga IOM dhe si rezultat është krijuar një Qendër të re pranuese për migrantët me financim të vlerësuar prej 450,000 Euro.

Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR)

UNHCR ka kontribuar aktivisht në të gjitha proceset që kanë të bëjnë me praninë e azilkërkuesve në Kosovë, fillimisht duke miratuar një kornizë legjislative në vitin 2008, pastaj duke vazhduar me zhvillimin e kapaciteteve institucionale për zbatimin e kornizës legjislative për azil. Një numër i konsiderueshëm trajnimesh dhe vizitash studimore në vendet me sistem të zhvilluar azili u organizuan për zyrtarët e DSHAM-së, me synim parësor zhvillimin dhe forcimin e kapaciteteve të tyre në menaxhimin e duhur të qendrave pranuese dhe përpunimin e kërkesave për azil. UNHCR-ja që nga viti 2012 ka ofruar mbështetje të plotë në themelimin dhe mirëmbajtjen e Qendrës për Azilkërkuesit në Vranidoll. E njëjta mbështetje është dhënë në vitin 2020 me hapjen e qendrave në Magurë dhe Mitrovicë.

Shërbimi Jezuit për Refugjatët (JRS)

JRS is an international organization operating in 57 countries around the globe. It supports and serves refugees and displaced persons by providing psychological counseling, reconciliation, advocacy, and educational programs. JRS work in Kosovo is focused on three (3) receiving centers for asylum seekers: Vranidoll/Vrani Do, Magurë/Magura, and Mitrovicë/Mitrovica. They are present daily in the receiving centers and provide the following services: Albanian language courses, computer courses, psychosocial support, medical, food, and sanitary support [1]. Moreover, JRS focuses on social interaction activities; it organizes entertaining activities for asylum seekers to familiarize them with the community and culture in Kosovo. Different entertaining activities inside and outside the reception centers are organized, including excursions to different cities/parts of Kosovo.

Programi për të Drejtat Civile në Kosovë (CRPK)

CRPK was founded in 1999 by The Norwegian Refugee Council (NRC). From 2004, it started functioning as an independent non-governmental organization in the area of human rights, and it is an implementing partner of the UNHCR in all activities related to service provision on legal assistance in Kosovo. Indeed, this includes the service provision for asylum seekers. CRPK has a specific pillar on supporting and protecting asylum seekers in legal representation; system includes border monitoring also. In 2021 (January-June), CRPK conducted 102 border/boundary visits and 19 border/boundary station visits.

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT)

QKRMT është themeluar në vitin 1999 si një organizatë joqeveritare që ofron shërbime për shëndetin mendor dhe fizik dhe çështje sociale. Synimi kryesor i saj ishte çrrënjësja e torturës, dhe me kalimin e viteve ka krijuar partneritete me institucione të ndryshme dhe organizata ndërkombëtare në zhvillimin e programeve për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe të mbijetuarit e tjerë të torturës. Shtyllat kryesore të veprimtarisë së QKRMT-së përbëhen nga: rehabilitimi, trajtimi dhe riintegrimi, të drejtat e njeriut, kërkimi dhe dokumentimi, avokimi dhe lobimi, dhe tema të ndërlidhura me fuqizimin ekonomik dhe riintegrimin.

Puna dhe veprimtaria e këtyre organizatave është vendosur në nivel qendror, ndërsa aktivitetet janë duke u zbatuar në rajonet e Kosovës, përfshirë rajonin e Mitrovicës dhe kampin Belvedere. Të gjitha aktivitetet dhe projektet e prezantuara mbulojnë rajonin e Mitrovicës dhe menaxhimin e qendrave të azilkërkesve dhe trajtimin e emigrantëve. Përveç këtyre akterëve, mediat lokale dhe kombëtare luajnë një rol vendimtar në transmetimin e informacionit në lidhje me trendet aktuale në rajonin e Mitrovicës. Platformat e

mediave lokale si Jepi Zë, Mitrovica Press, portali Kosovo Sever kanë luajtur një rol aktiv në informimin e qytetarëve për menaxhimin e sistemit të migracionit dhe azilit dhe funksionalitetin e qendrës Belvedere. Për më tepër, mediat kombëtare, përfshirë Indeks Online, Koha.net, RTV 21, Lajme 365, e shumë të tjera, kanë realizuar intervista dhe kanë ndarë raporte nga puna e autoriteteve publike dhe organizatave ndërkombëtare.

REKOMANDIME

-Decentralizimi i kapaciteteve institucionale

Të dhënat e hulumtimit tregojnë se situata në Mitrovicë sa i përket migrimit dhe sistemit të azilit është e menaxhuar mirë nën përgjegjësinë e institucioneve relevante publike në bashkëpunim të ngushtë me organizatat ndërkombëtare dhe kombëtare. Qasja e qeverisë ka qenë shumë pragmatike dhe fleksibile që nga fillimi i krizës së emigrantëve, duke supozuar se migrimi nëpër territorin e saj nuk ishte i përhershëm dhe vetëm transitor (kalimtar), ashtu sikur nëpër shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Megjithatë, institucionet rregulluan situatën në nivel qendror, duke e centralizuar të gjithë procesin.

Një centralizim i tillë i proceseve mund të pengojë menaxhimin efektiv të krizës në një nivel të caktuar me krijimin e një pengesepër monitorim dhe raportim sistematik, përfshirë çështjet themelore që kanë të bëjnë me sigurinë e popullsisë migrante që lëvizë e peregjistruar. Gjithashtu, një situatë e tillë krijon pengesë në sistemin e BE-së për shqyrtime rasteve të azilit dhe integrimin e suksesshëm të emigrantëve në planin afatgjatë. Prandaj, duhet të ndërmerren përpjekjet për zgjerimin e mëtutjeshëm të kapaciteteve institucionale në veri me rihapjen objektiv ekzistues pranues (kampin Belvedere) në Mitrovicën e Jugut. Përveç aspektit humanitar të sigurimit të ushqimit dhe strehimit, procesi duhet të përfshijë proceset e zakonshme të identifikimit, regjistrimit dhe monitorimit të lëvizjes së popullsisë, numrit dhe demografisë së emigrantëve.

- Sigurimi i mbledhjes, përpunimit dhe shkëmbimit të plotë të të dhënave

WNë kuadër të këtij hulumtimi, u vu re se një numër i konsiderueshëm i individëve emigrantë shmangin raportimin/regjistrimin në qendrat pranuese, duke përkeqësuar mosbesimin e tyre në zbatimin e ligjit dhe duke vepruar plotësisht "nën radar" (pa u vërejtur) tek autoritetet ose thjesht duke refuzuar të zbulojnë identitetin e tyre përmes fshehjes ose asgjësimit të dokumenteve të tyre identifikuese.

Ka gjithashtu raste të hyrjeve të shumta të emigrantëve pas përpjekjeve të numrta të dështuara për të hyrë në BE. Me pamundësinë e regjistrimit të një numri të emigrantëve nga autoritetet, informacioni nuk është i lehtë për t'u ndjekur, dhe shpesh është i shoqëruar me të dhëna të papërputhshme, në kuptim të kufizuar të proceseve dhe flukseve të migracionit.

Prioritetet në këtë çështje duhet të jetë në:

-Rritjen e shkëmbimit të të dhënave operacionale përmes një qasjeje bashkëpunuese nga poshtë-lart, nga institucionet/entitetet lokale në kombëtare dhe rajonale.

-Përmirësimin e mbledhjes së të dhënave të migrantëve në rajonin e Mitrovicës duke krijuar patrulla mobile të koordinatorit rajonal të DSHAM në zonat kufitare, dhe monitoruar rrugët më të shpeshta të përdorura nga emigrantët.

-Organizimin e punëtorive për të ngritur kapacitetet e koordinatorit rajonal të DSHAM-it të Mitrovicës për të përpunuar dhe kuptuar fluksin e migrimit në rajonin e Mitrovicës bazuar në një grup të të dhënave të përditësuara, solide dhe të besueshme.

-Shfrytëzimin e të dhënave të brendshme të mbledhura për politikëbërje. Vetëm të dhëna të sakta mund të përdoren në kontekstin e politikëbërjes dhe planifikimit strategjik.

-Themelimi i një "one-stop-shop" në rajonin e Mitrovicës

Ideja prapa "one-stop-shop" është qënë një kulm emigrantëve t'u ofrohet një gamë e gjerë e shërbimeve mbështetëse institucionale, pavarësisht statusit të tyre ligjor. Një hap në atë drejtim do të ishte një iniciativë e shoqërisë civile të Mitrovicës për të dalë me një propozim drejtuar qeverisë së Kosovës për themelimin e një "one-stop-shop" në Mitrovicën e Jugut/Veriut.

Shoqëria civile mund të bashkëpunojë dhe të bashkërendojë punën e saj me autoritetet, duke fuqizuar urën e besimit midis migrantëve dhe institucioneve, duke vepruar në cilësinë e akterëve të rëndësishëm në terren dhe në kuadër të kornizës kontekstuale të migracionit. Qeveria do të vepronte si një organizatë ombrellë, duke përcaktuar kompetencat e "one-stop-shop", dhe ruajtur rolin dhe kompetencat e saj ekzekutive në funksionimin e këtij objekti, përmes konsolidimit të operacioneve të "one-stop-shop" me strategjinë e saj për migrantët.

-Sigurimi i përfshirjes proaktive të shoqërisë civile në Mitrovicë

Shoqëria civile ka pasur gjithmonë fuqi substanciale për të bërë ndryshime në marrëdhëniet komplekse sociale dhe etnike në Mitrovicë, përmes përvetësimit të shumë qasjeve dhe mekanizmave të ndryshëm për t'u përshtatur me vështirësitë e një qyteti të ndarë, shpesh duke vepruar në mënyrë altruiste për të mirën e përbashkët të komunitetit. Përfshirja proaktive e shoqërisë civile në nivel lokal në çështjen e migrantëve mund të sjellë sërish rezultate të rëndësishme, duke formësuar dhe definuar propozime në adresimin e aspekteve humanitare dhe sociale të krizës së emigrantëve në rajonin e Mitrovicës. Përfshirja e shoqërisë civile do të ishte e dobishme në ndërtimin e strukturave të qëndrueshme organizative përmes mentorimit dhe këshillimit, duke vepruar si ndërmjetës social/kulturor, duke u përgjigjur në mënyra të mundshme, inovative dhe duke zhvilluar burime dhe njohuri, dhe duke forcuar përfundimisht kapacitetin e mekanizmave kryesorqeveritar.

Shoqëria civile e Mitrovicës do të vepronte si një zgjerim i shërbimeve institucionale në rajonin e Mitrovicës, duke iu ofruar emigrantëve dhe azilkërkuesve komoditete të ndryshme si qasja në informacion, udhëzime për procedurat e azilit, gjendjen aktuale në pikat kufitare, situatën e azilit në vendet e BE-së, ndihmë juridike dhe humanitare, ofrimin e të gjithë materialit informativ në gjuhët amtare të emigrantëve, dhe tejkalimit të dallimeve kulturore dhe gjuhësore.

Ajo mund të bartë praktikën pozitive dhe përvojën thelbësore të fituar gjatë dy dekadave të fundit tek autoritetet kombëtare, përmes konsolidimit dhe trajtimit të përbashkët të problemeve. Përfundimisht, kjo do të formojë një memorie institucionale të autoriteteve kombëtare, duke i ndihmuar ata të krijojnë mekanizma migratorë më të fuqishëm, jo idealë në asnjë mënyrë, por sigurisht më të qëndrueshëm dhe më efektivë për menaxhimin e krizës së migrantëve.

- Sigurimi i përfshirjes proaktive të autoriteteve

Autoritetet mund të ofrojnë aktivitetet e mëposhtme për palët e interesuara në Mitrovicë, duke mundësuar një shtrirje më të madhe të shërbimeve:

- Krijimi i forume/punëtorive diskutimi për shoqërinë civile në Mitrovicë, duke e njohur atë me mandatin e institucioneve, shërbimet dhe objektet në dispozicion të emigrantëve, dhe duke plotësuar dhe forcuar mbështetjen e tyre në ofrimin e shërbimeve.

- Realizimi i vizitave të rregullta të palëve kryesore të interesit në Mitrovicë në qendrat pranuese dhe objektet e DSHAM-it, njohja e shoqërisë civile me mandatin, arritjet dhe planet e tyre, duke i angazhuar ata në tema të synuara.

- Organizimi i seminareve me zyrtarët e zbatimit të ligjit, lehtësimi i shkëmbimit të informacionit, shqetësimeve, këshillimi dhe ndërlidhja me zyrtarët përmes mekanizmave të krijuar.

- Organizimi i ngjarjeve mediatike, shkëmbimi i përditësimeve dhe ndjekja e zhvillimeve më të fundit

- Zhvillimi i rrjeteve të vullnetarizmit nëpërmjet trajnimeve dhe seminareve për OJQ-të, shoqatat, individët, etj., duke ofruar të dhëna për ndërtimin e kapaciteteve në adresimin e krizës së migracionit.

Autoritetet duhet të jenë më transparente në ofrimin e informacioneve për popullatën e Mitrovicës rreth pranisë së migrantëve, të drejtat, detyrimet dhe nevojat për një diskurs publik në rritje që stereotipizon migrantin.

Bashkëpunimi për këtë çështje do të ishte i natyrshëm për natyrën humanitare dhe konceptin e shoqërisë moderne, duke avokuar për mbrojtjen e njerëzve në nevojë, duke sjellë përpara vlerat e vërteta morale dhe argumentimin etik në mbështetje për t'i parë emigrantët si asgjë më shumë se qenie njerëzore.

REFERENCAT

- Arbresh Info. (2021, January 29). Migrantët në Kosovë ndihmohen me 1 mijë çanta emergjente [Video]. YouTube.https://www.youtube.com/watch?v=hnAFWz_sT6E
- AUTORITETI QEVERITAR PËR MIGRIM. (2018, December). Profili i zgjeruar i migrimit 2013–2017. Ministry of Internal Affairs.
- AUTORITETI QEVERITAR PËR MIGRIM. (2020). PROFILI I LEHTË I MIGRIMIT 2019. Ministry of Internal Affairs.
- Balkan Policy Research Group (BPRG). (2020, September). KOSOVA: TRENDET E MIGRACIONIT KËRKOJNË NJË QASJE TË RE STRATEGJIKE.https://balkanpolicygroup.org/wp-content/uploads/2020/10/Kosova_Trendet_e_Migrimit-kerkojne-nje-qasje-te-re-strategjike-shqip.pdf
- Batusha, B. (2018, December 29). Sirianët, azilkërkuesit kryesorë në Kosovë. Ballkani.info. Retrieved 2021, from <https://ballkani.info/sirianet-azilk-erkuesit-kryesore-ne-kosove/>
- Batusha, B. (2019, September 20). Irakianët dhe sirianët ia kanë mësyre Kosovës. Ballkani.info. Retrieved 2021, from <https://ballkani.info/irakianet-dhe-sirianet-ia-kan-me-syre-kosoves/>
- Božović, N. (2021, October 23). Nova migrantska ruta: Od Skadra, preko Kosova, pa prugom ka Raški. N1. Retrieved 2021, from <https://rs.n1info.com/vesti/nova-migrantska-ruta-od-skadra-preko-kosova-pa-prugom-ka-raski/>
- Civil Rights Program Kosovo. (2021, June). Newsletter: ASYLUM AND MIXED MIGRATION (No. V1).https://www.crpkosovo.org/Articles/1/imagenes/17-09-2021/598103_ASYLUM_AND_MIXED_MIGRATION_-_NEWSLETTER.pdf
- IOM Kosovo. (2021, 15 November). IOM and EU support the establishment of a new reception center for migrants | International Organization for Migration. Retrieved 2021, from <https://kosovo.iom.int/news/iom-and-eu-support-establishment-new-reception-center-migrants>
- Jepi zë. (2021, November 21). Dhjetëra sirianë zbarkojnë në qytetin e Mitrovicës, nuk dihet nga erdhën. Retrieved 2021, from <https://www.facebook.com/1416590715226211/posts/3337243766494220/?d=n>
- JRS. (2021, 03 August). Kosovo: assisting asylum seekers in reception centres. Retrieved 2021, from <https://jrs.net/en/country/kosovo/>
- K, A. (2021, April 22). Pamje/ Emigrantët kapen duke hyrë ilegalisht në Kosovë në kamionin me mallra. Indeks Online. Retrieved 2021, from <https://indeksonline.net/pamje-emigrantet-kapen-dduke-hyre-ilegalisht-ne-kosove-ne-kamionin-me-mallra/>
- Klan Kosova. (2021, August 4). Banorët e Magurës në hall me emigrantët - 04.08.2021 - Klan Kosova [Video]. YouTube.<https://www.youtube.com/watch?v=7GbYBJQEITY>
- KOHA.net. (2020, April 12). Krasniqi: Kosova shfrytëzohet si transit nga të ikurit nga Siria. Marrë në 2021, nga <https://www.koha.net/arberi/211747/krasniqi-kosova-shfrytezohet-si-transit-nga-te-ikurit-nga-siria/>
- Konushevci, A. (2020, March 2). Emigrantët nuk preferojnë azilin, qëndrojnë

ilegalisht në Kosovë. Radio Evropa e Lirë. Marrë në 2021, nga <https://www.evropaelire.org/a/emigrantet-azil-kosove-30462776.html>

- Konushevc, A. (2021, 18 June). Bie numri i emigrantëve ilegalë, problem identifikimi. Radio Evropa e Lirë. Marrë në 2021, nga <https://www.evropaelire.org/a/bie-numri-emigranteve-ilegale-problem-identifikimi/31314723.html>

- Kosova Press. (2020, November 22). Më shumë se 2600 emigrantë në Kosovë, mbi 50 për qind vetëm nga Siria. Marrë në 2021, nga <https://kosovapress.com/me-shume-se-2600-emigrante-ne-kosove-mbi-50-per-qind-vetem-nga-siria/>

- KRCT. (n.d.). Advocacy and Lobbying – KRCT. KRCT. Marrë në 2021, nga <https://krct.org/areas-of-work/advocacy-and-lobbying/>

- KTV Kohavision. (2020, March 4). Refugjatet siriane ne Kosove [Video]. YouTube. https://www.youtube.com/watch?v=FbGjpZHB_bl

- L, G. (2020, October 18). Vështirësitë që imponoi pandemia në qendrën e azilit për 27 familjet. Arbresh.Info. Marrë në 2021, nga <https://www.arbresh.info/lajmet/veshtiresite-qe-imponoi-pandemia-ne-qendren-e-azilit-per-27-familjet/>

- Lajme 365. (2020, May 7). Rruga Ballkanike edhe më tej 'lojë e jetës dhe vdekjes.' LAJME365. Marrë në 2021, nga <https://lajme365.com/rruga-ballkanike-edhe-me-tej-loje-e-jetes-dhe-vdekjes/>

- Ministry of Internal Affairs. (n.d.). Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion i MPBAP. Marrë në 2021, nga <https://mpb.rks-gov.net/f/21/Department-of-Citizenship,-Asylum-and-Migration>

- Petrov, S. (2021, November 24). Kampovi za mučenje i silovanje na srpsko-makedonskoj granici VIDEO. NOVA portal. Marrë në 2021, nga <https://nova.rs/svet/kampovi-za-mucenje-i-silovanje-na-srpsko-makedonskoj-granici-video/>

- Portali RTV 21. (2020, November 15). EMIGRANTET NE MITROVICE [Video]. YouTube. <https://www.youtube.com/watch?v=zEz15oBtc64>

- SH, O. (2021, August 19). Tentoj të fus ilegalisht në Kosovë 61 emigrant nga Siria, Irani dhe Iraku, arrestohet shoferi. Indeks Online. Marrë në 2021, nga <https://indeksonline.net/tentoj-te-fus-ilegalisht-ne-kosove-61-emigrant-nga-siria-irani-dhe-iraku-arrestohet-shoferi/>

- UNHCR. (2021, 19 October). World refugee day 2021 – The event of inauguration of the refurbished Asylum Center in Vranidoll, Prishtinë/Pristina Municipality. UNHCR South Eastern Europe. Marrë në 2021, nga <https://www.unhcr.org/see/13849-world-refugee-day-2021-the-event-of-inauguration-of-the-refurbished-asylum-center-in-vranidoll-prishtine-pristina-municipality.html>

- UNHCR. (n.d.). What are our results? UNHCR South Eastern Europe. Marrë në 2021, nga <https://www.unhcr.org/see/where-we-work/kosovo/what-are-our-results>

Veseli, K. L.-. (2017, June 20). Refugjatët e strehuar në Kosovë, presin rastin të ikin për në vendet e BE-së. Radio Evropa e Lirë. Marrë në 2021, nga <https://www.evropaelire.org/a/28569294.html>



This Project is funded
by the European Union

